

**PROPOZIM - ORË PËR REALIZIMIN E
PËRMBAJTJEVE NGA FUSHA**

EDUKIMI

MEDIATIK

DHE KULTURA

MEDIATIKE

KLASA I



KLASA I

EDUKIMI

MEDIATIK

DHE KULTURA

MEDIATIKE



EDUKIMI MEDIATIK DHE EDUKIMI KULTUROR NË MËSIMIN KLASOR

- Doracak për mësimdhënësit e klasës I -

Botues: Instituti Maqedonas i Mediave
Rr. „Jurij Gagarin“, 17/1-1
1000 Shkup

Byroja për Zhvillimin e Arsimit
Rr. „Rugjer Boshkoviq“, nr. 20
1000 Shkup

Redaktorë: Mitko Çeshllarov
Ajshe Ajrullai

Autorë dhe bashkëpunëtorë profesionalë: Mihajllo Llahtov
Marina Dimitrieva-Gjorgjievaska
Olivera Todoroska
Mitko Çeshllarov
Ajshe Ajrullai

Redaksia profesionale: Mihajllo Llahtov
Vesna Nikodinoska

Përkthyer nga: Sefer Tahiri

Lektura: Shpëtim Hiseni

Dizajni dhe përpunimi teknik: Koma Dizajn

Doracaku është përgatitur në kuadër të Projektit të USAID-it për edukim mediatik “Të rinjtë mendojnë”, të cilin e realizojnë IREKS dhe partnerët lokalë Instituti Maqedonas i Medias, Instituti i Studimeve të Komunikimit dhe Forumi Rinor Arsimor, në bashkëpunim me Byronë e Zhvillimit të Arsimit dhe Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës.

Mbështetje për përgatitjen e Doracakut është siguruar nga populli amerikan përmes Agjencisë së SHBA-së për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID). Përbajtja e Doracakut është përgjegjësi e IREKS-it dhe Institutit Maqedonas të Medias (MIM) dhe nuk i paraqet qëndrimet e USAID-it ose të Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës.



Hyrje

Sot, në kohën e “realitetit të ri mediatik”, kur të rinjtë çdo ditë janë të ekspozuar në një numër të madh të informacioneve, përmes platformave dhe teknologjive mediatike tradicionale dhe sidomos digjitale, është e domosdoshme që përmes arsimit, në shkollë, ata të pajisen me dije dhe shkathtësi për analizim kritik të përmbajtjeve mediatike. Është e nevojshme që nxënësit të mund të kufizojnë “kryesoren dhe krahasimin” në gjithçka që lexojnë, dëgjojnë dhe shohin, t’i njohin elementët e propagandës ose porosinë e fshehta reklamuese, të njohin gjuhën implicite dhe eksplicite të urrejtjes. Përmes mësim, nxënësit duhet të aftësohen për shfrytëzim efikas të informacioneve dhe përmbajtjeve mediatike dhe platformave, ndërsa përmes pjesëmarrjes së tyre aktive në mediat e ndryshme sociale, pritet që të veprojnë me përgjegjësi dhe në mënyrë kritike t’i qasen përmbajtjes të cilën e “krijojnë”.

Në këtë drejtim aplikohet arsimimi për edukimin mediatik në programet e reja mësimore me rezultate të caktuara nga mësimi, përmbajtjet, standardet për vlerësim dhe shembuj të aktiviteteve, me arritjen dhe realizimin e të cilëve nxënësit më me përgjegjësi do t’u qasen mediave, do t’i analizojnë porosinë dhe do t’i vlerësojnë informacionet të të cilat arrijnë, do t’i shfrytëzojnë informacionet që i marrin përmes mediave dhe vet do të krijojnë porosi mediatike në mënyrë të sigurt dhe me përgjegjësi.

Në programet mësimore nga klasa e parë deri në të pestën në arsimin fillor, mësimi i edukimit mediatik është i integruar në një numër të madh të përmbajtjeve dhe aktiviteteve përmes lëndëve të ndryshme mësimore. Kështu që, në kuadër të programit mësimor të lëndëve Gjuhë Maqedonase, Gjuhë Shqipe, Gjuhë Turke, Gjuhë Serbe dhe Gjuhë Boshnjake, është përgatitur kapitull i posaçëm i titulluar *Edukimi mediatik dhe kultura mediatike*.

Për arritjen e suksesshme të rezultateve nga mësimi i përcaktuar në këtë kapitull të programit mësimor, është e nevojshme që të realizohen aktivitete cilësore dhe kreative në orë, përmes të cilave nxënësit me përvojë do të “edukohen” dhe do të mësojnë për mediat dhe rolin e tyre.

Doracakut për mësimdhënës, të cilët realizojnë mësim në lëndët Gjuhë Maqedonase, Gjuhë Shqipe, Gjuhë Turke, Gjuhë Serbe dhe Gjuhë Boshnjake do t’u ndihmojë mësuesve klasorë gjatë planifikimit dhe realizimit të orëve, në të cilat përpunohen përmbajtjet e edukimit mediatik dhe kulturë mediatike. Doracakut është përgatitur me qëllim që të jetë mbështetje dhe inspirim në punën e mësimdhënësve për realizimin e mësimin të suksesshëm dhe kreativ.

Çdo shembull për realizimin e aktiviteteve në orë ka të bëjë me një përmbajtje të caktuar, e lidhur me standardet përkatëse për vlerësim nga programi mësimor që duhet të arrihet përmes aktiviteteve në orë. Gjithashtu, janë renditur edhe pajisjet e nevojshme për realizimin e aktiviteteve gjatë orës.

Shembujt në orë janë zhvilluar përmes aktiviteteve për pjesën hyrëse, kryesore dhe përfundimtare të orës. Qëllimi i aktiviteteve hyrëse është t’i aktivizojnë paradijet e nxënësve

dhe t'i udhëzojnë për përmbajtjen. Në të shumtën e rasteve janë të konceptuara përmes hulumtimeve të shkurtra ose përmes diskutimeve me qëllim që të sqarojnë ose të "ndihen" shembujt që do të përpunohen në orë. Në pjesën që ka të bëjë me aktivitetet nga pjesa kryesore e orës, është dhënë përshkrim i detajuar i aktivitetit/aktiviteteve, përmes të cilit/të cilëve nxënësit do të hulumtojnë dhe pastaj me përvojë do të mësojnë, si dhe propozim për mënyrën e organizimit të punës së nxënësve në grupe dhe në çifte. Aktivitetet kryesore për orët në doracak ofrojnë diapazon të gjerë të ideve për mësim dhe për veprim kreativ. Ndërkaq, aktivitetet përmblylëse janë të drejtuara nga nxjerrja e konkluzioneve përmes diskutimeve të realizuara. Pjesa e fundit e shembujve për orët është reflektim, në të cilin janë ofruar pyetje për atë se çfarë kanë mësuar nxënësit, rezyme dhe lidhshmëri mes të mësuarës me jetën e tyre të përditshme.

Mësimdhënësit mund t'i shfrytëzojnë shembujt për realizimin e orëve për edukim mediatik nga doracaku si ide për aktivitete, përmes të cilave do të arrihen standardet për vlerësim gjatë realizimit të përmbajtjeve të lartpërmendura nga programi mësimor në gjuhën maqedonase, gjuhën shqipe, gjuhën turke, gjuhën serbe dhe gjuhën boshnjake. Aktivitetet mund të ndërmerren ashtu si janë dhënë, mund të përshtaten ose të ndryshohen, përkatësisht të modifikohen në përputhje me idetë e mësimdhënësit, nevojat dhe interesat e nxënësve dhe përparimin e tyre në procesin e mësimit, pajisjet e disponueshme për punë, kushtet në shkollë etj. Ato paraqesin shembuj për mësim kreativ dhe praktik për edukimin mediatik sipas programeve të reja mësimore. Në bazë të këtyre shembujve, mësimdhënësit lehtë mund të zhvillojnë skenarë për realizimin e orëve, varësisht nga ambienti dhe kushtet në të cilat e realizojnë mësimin. Në mënyrë shtesë, mësimi i integruar mundëson që disa nga standardet dhe aktivitetet për arritjen e tyre, të lidhen edhe me përmbajtje të ngjashme të përfshira në lëndë të tjera.

Pritet që ky doracak, përveç që do të mbështetet nga mësimdhënësit gjatë planifikimit dhe realizimit të mësimit, në të njëjtën kohë të jetë edhe nxitje për kreativitet më të madh, motivim dhe entuziazëm në punë.

Udhëzim për mësimdhënësin/mësimdhënësen për shfrytëzimin e Doracakut për Edukim Mediatik për klasën I

Më shumë informacione për termat e rinj dhe konceptet thelbësore, mësimdhënësi mund të lexojë në *Fjalorin e fushës së edukimit mediatik*, që është pjesë e këtij doracaku. Në këtë mënyrë, mësimdhënësi do të mund t'i aftësojë përmbajtjet sipas moshës së nxënësve dhe më lehtë mund t'ua transmetojë, me qëllim që ata t'i kuptojnë.

KLASA I

EDUKIM MEDIATIK DHE KULTURË MEDIATIKE

Sipas programit mësimor në lëndën Gjuhë Shqipe për klasën e parë, në fushën e Edukimit Mediatik dhe Kulturës Mediatike janë përfshirë si vijon:

Përmbajtje (dhe fjalë)

- Mediat dhe përmbajtjet mediatike për fëmijë (filma të animuar, emisione televizive, përmbajtje interneti, revista për fëmijë)
- Ngjarje kulturore (shfaqje teatrale për fëmijë, shfaqje kukullash)

Në fund të vitit shkollor, për këtë fushë nxënësit duhet t'i arrijnë rezultatet nga mësimi në nivel të dijes, aftësive, shkathtësive, qëndrimeve dhe vlerave, si vijon:

Rezultate nga mësimi

Nxënësi/nxënësja do të jetë i/e aftë:

1. Të ndajë informacione nga llojet e ndryshme të mediave me ndihmën e mësimeve;
2. Ta kuptojë përmbajtjen e shfaqjes së ndjekur teatrale për fëmijë dhe/ose shfaqjes së kukullave.

Fjalor nga fusha e Edukimit Mediatik¹

Media ➤ Mjet bazë për komunikim masiv, përmes të cilave njerëzit marrin informacione dhe argëtim, siç janë radiot, televizioni, shtypi dhe platformat e internetit (mediat online, mediat sociale).

Televizioni ➤ Televizioni është media, e cila transmeton informacionet duke kombinuar pamje lëvizëse, zë dhe tekst.

Radio ➤ Radio është media, përmes së cilës transmetohen informacione (zë dhe të folur) në largësi të madhe përmes pajisjeve të posaçme (radiostacione).

Radiorrëfim ➤ Radiorrëfimi është transmetim, që si gjuhë bazë e shfrytëzon zërin (zhurmën). Ky zhanër bazohet në dialog, muzikë dhe efektet e zëshme, me qëllim që në mënyrë interesante dhe tërheqëse ta ketë vëmendjen e dëgjuesit dhe t'ia paraqesë karakteret e rrëfimit.

Reklama ➤ Reklamata bëhen në mënyrë interesante me qëllim që të tërheqin vëmendjen e lexuesve/dëgjuesve/shikuesve duke shfrytëzuar muzikë, ngjyra dalluese, fotografi, ilustrime dhe efekte të tjera mbresëlënëse. Në të shumtën e rasteve, qëllimi i reklamave është ta bindë publikun të ndërmarrë ndonjë aksion, si për shembull, të blejë ndonjë prodhim. Reklamata mund të paraqiten përmes fotografisë dhe tekstit, formatit audio dhe video, ndërsa mund të hasen në revista, në televizion, në radio, por edhe në rrugë, në autobusë, ndërtesa dhe objekte të tjera.

Film i animuar/film vizatimor ➤ Filmi i animuar është teknikë e filmit, e cila shfrytëzon vizatime, të cilat më pas, në procesin e prodhimit shndërrohen në pamje lëvizëse.

¹ Më shumë terma të përfshirë në këtë Fjalor janë të harmonizuara me Fjalorin e Edukimit Mediatik, të cilin e përgatiti Instituti i Studimeve të Komunikimit (2023), si dhe me "Doracakun për trajnues të edukimit mediatik – Mësojmë të dallojmë", përgatitur në kuadër të Projektit të USAID për edukimin mediatik "Të rinjtë mendojnë". Fjalori u dedikohet mësimdhënësve, ndërsa shpjegimi dhe përkufizimi i fjalëve nuk duhet të jetë pjesë e programit me nxënësit në mësimin klasor.

**PROPOZIM-ORË PËR REALIZIMIN E
PËRMBAJTJEVE NGA KAPITULLI**

**EDUKIMI
MEDIATIK
DHE EDUKIMI
KULTUROR**

NË KLASËN I



MEDIAT DHE PËRMBAJTJET MEDIATIKE PËR FËMIJË

(5 orë)



Ora 1

Televizioni si media

Standardi i vlerësimit:

Nxënësi/nxënësja:

- Ndan informacione nga dëgjimi i përmbajtjes mediatike sipas udhëzimeve të dhëna (nga programi televiziv).

Burime për orët:

- Kuti kartoni;
- ngjyra;
- ngjytës;
- letër.

Pjesa hyrëse e orës mësimore

1 Aktiviteti

Ndarja e informacioneve nga televizori (realizimi 10 minuta)

Mësimdhënësi/mësimdhënësja i nxit nxënësit të mendojnë për ndonjë informacion, të cilin e kanë dëgjuar dhe/ose e kanë parë në televizor, ndërsa do të donin ta ndajnë me klasën. Nxënësit diskutojnë sipas pyetjeve të cilat i parashtron mësimdhënësi:

- A shikoni televizor?
- Çfarë ishte interesante nga ajo që patë në televizor këtyre ditëve?
- Cili është emisioni i preferuar?
- Cili karakter ju pëlqen më së shumti, ndërsa cili më pak?
- A keni dëgjuar apo mësuar diçka të re ose që ishte e dobishme?
- Sa kohë në ditë kaloni para televizorit?

Pas diskutimit, mësimdhënësi/mësimdhënësja me parafrazimin e përgjigjeve të nxënësve, arrin në përfundimin se me televizionin si media pranojmë informacione/porosi përmes zërit, fotografisë, videos, muzikës dhe tekstit.

Pjesa kryesore e orës mësimore

1 Aktiviteti

Aktiviteti 1: Krijojmë TV-marrës (realizimi 20 minuta)

Nxënësit janë të ndarë në grupe. Të gjitha grupet kanë për detyrë të krijojnë *TV-marrës* nga kuti të zbrazëta kartoni, të cilat paraprakisht i ka siguruar mësimdhënësi, ose, mësimdhënësi mund të sjellë një televizor të krijuar paraprakisht nga kutia e kartonit. Nxënësit i shfrytëzojnë ngjyrat për të vizatuar butonat dhe për ta ngjyrosur TV-marrësin. Në mënyrë shtesë, mund të krijojnë edhe telekomandë dhe të vizatojnë logon e televizionit të tyre.

TV-marrësi, të cilin e kanë krijuar nxënësit, do të shfrytëzohet për transmetimin e lajmeve. Secili grup duhet të gjejë emër për TV-marrësin e vet dhe të zgjedhë një përfaqësues i cili do të jetë prezantues i lajmeve të tyre. Nxënësit e tjerë janë publiku.

Me ndihmën e mësimitdhënësit/mësimitdhënëses, nxënësit duhet të bëjnë një lajm të shkurtër, të përbërë nga disa fjali, të cilin do ta prezantojnë gojarisht. Mësimitdhënësi ndihmon ata ta përpilojnë lajmin me atë që u parashtron disa pyetje: Çfarë ka ndodhur? Kush e ka bërë atë? Kur ka ndodhur ngjarja/veprimi? Ku dhe si? Nxënësit mund të përgjigjen në një deri në dy pyetje të parashtruara me qëllim që ta prezantojnë lajmin.

Shembuj për lajme që do t'i prezantojë mësimitdhënësi, ndërsa nxënësit duhet t'i rrëfejnë, përkatësisht t'i parafranojnë::

3 Shembulli

Shembulli 1: Në parkun e qytetit zbriti një anije kozmike me tre alienë nga planeti Neptun. Ata i rrëfyan policisë se kanë mbetur pa karburant dhe është dashur të zbresin për të mbushur benzinë.

Shembulli 2: Dy nxënës të shkollës "Hasan Prishtina" në Shkup kanë ngacmuar qenin e fqinjit Pero. Qeni qëndronte i qetë, por dy trazovaçë pa kurrfarë arsye filluan ta ngrenë për bishti.

Shembulli 3: Ekipi i futbollit i shkollës "Naim Frashëri" fitoi në garën e fundit për këtë sezon, që u mbajt në Stadiumin e Qytetit në Shkup, me 5 gola epërsi. Lojtari më i mirë ishte nxënësi Artan Berisha, i cili shënoi 3 gola.

Sipas këtij shembulli, mësimitdhënësi/mësimitdhënësja mund të mendojë edhe disa lajme të shkurtra të ngjashme. Secili prezantues do të duhet t'i prezantojë lajmet e shkurtra përmes kutisë TV. Publiku dëgjon me vëmendje, sepse pas prezantimit të lajmeve, do të duhet të përgjigjet në disa pyetje që kanë të bëjnë me lajmin.

Pjesa përmbyllëse e orës mësimore

1 Aktiviteti

Arritja deri tek informacioni thelbësor i tekstit (realizimi 10 minuta)

Pas lajmeve të prezantuara, nxënësit të cilët ishin publiku përmes diskutimit duhet të përgjigjen në disa pyetje të cilat i parashtron mësimitdhënësi, që kanë të bëjnë me çdo lajm veç e veç:

- Çka ishte më e rëndësishme nga secili lajm që e dëgjuat? Përse kjo ishte më e rëndësishme?
- A do të shtonit edhe ndonjë informacion nga lajmi të cilin e prezantuan bashkëmoshatarët?



Reflektim

- Çka mësuat në orën e sotme?
- A është interesant të jesh në televizion?

Ora 2

Radioja si media

Standardi i vlerësimit:

Nxënësi/nxënësja:

- Ndan informacioni nga përmbajtja e dëgjuar mediatike sipas udhëzimeve të dhëna (kronikë nga programi në radio).

Burime për orët:

- mikrofon i improvizuar;
- fletë të bardha ose kartonë;
- ngjyra.

14

Pjesa hyrëse e orës mësimore

1 Aktiviteti

Flasim për radion (realizimi 5 minuta)

Mësimdhënësi/mësimdhënësja përmes pyetjeve hap diskutimin për karakteristikat e radios dhe në çfarë mënyre i transmeton informacionet (për shembull, me zë, efekte të zëshme, muzikë).

Mësimdhënësi ua parashtron nxënësve pyetjet si vijon:

- Cili nga familjarët e tyre më shpesh dëgjon radio?
- Ju a dëgjoni radio?
- Çka dëgjoni më shpesh në radio (muzikë, reklama, emisione në radio...)
- Ku dëgjoni radio (në shtëpi, në makinë...)?

Mësimdhënësi u shpjegon nxënësve se radio në të kaluarën ka qenë shumë e popullarizuar si media, ndërsa sot ekzistojnë radio që mund të dëgjohej edhe në internet. Mësimdhënësi ua tregon nxënësve disa fotografi ose pamje në të cilat tregohet radio. Nëse ka mundësi, ua tregon radion në shkollë ose ua lëshon radion në internet.

Pjesa kryesore e orës mësimore

1 Aktiviteti

Radiorrëfimi (realizimi 25 minuta)

Mësimdhënësi/mësimdhënësja në tavolinën e saj vendos mikrofon të vërtetë ose të improvizuar. U shpjegon fëmijëve se sot ai/ajo do të jetë udhëheqës/udhëheqëse e emisionit në radio. Të gjithë do të duhet t'i mbyllin sytë dhe ta dëgjojnë përrallën "Bukuroshja e fjetur" (nëse është më e përshtatshme për programin mësimor, mund të zgjidhet edhe ndonjë përrallë tjetër).

Derisa mësimdhënësi/mësimdhënësja e lexon përrallën, nxënësit duhet t'i imagjinojnë skenat për lindjen e princeshës, ardhjen e zanave, shpimin nga boshti, kështjellën e mbuluar nga e keqja për aq shumë vite, ardhjen e princit... sipas udhëzimeve të dhëna paraprakisht nga mësimdhënësi/mësimdhënësja. Për ta forcuar efektin, mësimdhënësi/mësimdhënësja, në rolin e udhëheqësit/

udhëheqëses së emisionit, duhet të theksojë disa pjesë, ta imitojë zërin e erës, stuhisë, goditjen e dritareve kur vjen zana e keqe etj.

Kur të përfundojë përralla, nxënësit duhet t'i hapin sytë. Ata me radhë duhet të rrëfejnë pjesë nga përralla, ndërsa më pas duke u bazuar nga pyetjet e parashtruara nga mësimitdhënësi/mësimitdhënësja. Është e rëndësishme që mësimitdhënësi/mësimitdhënësja të parashtrojë pyetje, të cilave nuk u është dhënë përgjigje në mënyrë precize në rrëfim. Nxënësit duhet të rrëfejnë se si ata i kanë imagjinuar gjërat derisa në rrjedhë ishte rrëfimi.

1 Shembull për pyetje:

- Çfarë ngjyre ishte fustani i princeshës? Vallë në vend të ngjyrës rozë, mund të jetë edhe i kaltër?
- A thua të gjitha princeshat mbajnë vetëm fustane rozë?
- Me çfarë kali ka ardhur princi?
- Si është dukur zana e keqe?
- Si është dukur boshti në të cilin është shpuar princesha?
- A ka pasur më pas më pas dasmë të madhe dhe çfarë ushqimi është shërbyer?

Pjesa përmbyllëse e orës mësimore

1 Aktiviteti

Pyetje për nxitjen e imagjinatës (realizimi 10 minuta)

Në pjesën përmbyllëse të orës nxënësit duhet të përgjigjen në disa pyetje, të cilat do t'i ndihmojnë të nxjerrin informacione kyçe nga radiorëfimi, të cilin e kanë dëgjuar gjatë pjesës kryesore të orës:

Kush është personazhi kryesor në përrallë? Përgjigje e pritur: Princesha dhe zana e keqe.

Çfarë ka ndodhur? Përgjigje e pritur: Zana e keqe e ka mallkuar princeshën. Princesha është shpuar në bosht dhe ka rënë në gjumë me vite të tëra në kështjellë.

Përse ka ndodhur? Përgjigje e pritur: Sepse zana e keqe ishte ndjerë e ofenduar, pasi nuk ishte e ftuar në pagëzimin e princeshës.

Kur ka ndodhur kjo përrallë? Përgjigje e pritur: Në një kohë të lashtë, shumë më herët.

Përmes parashtrimit të pyetjeve, mësimitdhënësi i udhëzon nxënësit se si të nxjerrin informacion të rëndësishëm nga ndonjë përmbajtje mediatike, të dëgjuar në radio.

Mësimdhënësi shpjegon se edhe pse radioja nuk transmeton pamje, përmes zërit të rrëfyesit, muzikës dhe efekteve, u mundëson nxënësve (dëgjuesit) vetë t'i imagjinojnë personazhet, ngjarjet dhe situatat, si për shembull, bukuroshen e fjetur, fustanin e saj ose princin në kalë.



Reflektim

- Çka mësuat në orën e sotme?
- Vallë radioja transmeton pamje apo zë?
- Cila media na lë hapësirë më të madhe për të fantazuar dhe për t'u menduar – radioja ose televizioni?



Ora 3

Dallojmë informacione thelbësore nga reklamata

Standardi i vlerësimit:

Nxënësi/nxënësjë:

- Dallon informata nga përmbajtja e dëgjuar mediatike sipas kaheve të dhëna (teksti i reklamës).

Burime për orët:

- Tabela (ose tabela e mençur);
- lidhje interneti.

Pjesa hyrëse e orës mësimore

1 Aktiviteti

Aktiviteti hyrës për reklama (realizimi 10 minuta)

Mësimdhënësi/mësimdhënësjë fillon bisedën me nxënësit për atë se çfarë janë reklamata, për çfarë shërbejnë dhe ku kanë vërejtur reklama. Mësimdhënësi/mësimdhënësjë i bën pyetjet si vijon:

- A e dini se çfarë janë reklamata?
- Ku keni vërejtur ndonjë reklamë (në TV, në Jutjub, në revista, në autobus, në ndërtesë, në rrugë etj.)?
- Kush mund të rrëfejë ndonjë reklamë që e ka parë?
- Çfarë më së shumti ju ka lënë përshtypje ose ju ka pëlqyer – muzika, zëri i reklamës, ilustrimet, fotografitë etj.?
- A u kujtohet ndonjë reklamë që e kanë parë në rrugë?

Pjesa kryesore e orës mësimore

1 Aktiviteti

Nxjerrja e informatave thelbësore nga reklamata (realizimi 20 minuta)

Nxënësit me vëmendje shikojnë një reklamë, që e prezanton mësimdhënësi, për shembull për prodhimet e "Mekdonallds" (<https://www.youtube.com/watch?v=iQwbReKEvwU>), për smokin "Stobi Flips" (<https://www.youtube.com/watch?v=6vzk0jDJluw>; <https://www.youtube.com/watch?v=0cWodGIVR1A>) ose për lëngjet "Viva" (<https://www.youtube.com/watch?v=0QmROISYJG4>).

Pas shikimit të videos, nxënësit kanë detyrë të rrëfejnë për çfarë është reklama, përkatësisht t'i nxjerrin informatat më të rëndësishme nga ajo që kanë parë. Mësimdhënësi/mësimdhënësjë e orienton diskutimin dhe i jep pyetjet në vijim, të cilave nxënësit duhet t'u përgjigjen:

- Çfarë shikojmë?
- Kujt i përket kjo video/kjo reklamë?
- Çfarë më së shumti u pëlqye në video (muzika, ngjyrat, linqet)?

↳ Pse është bërë kjo video – të na zbavitë, të na mësojë diçka ose të na shesë ndonjë prodhim?

↳ Kush e ka bërë videon?

Pastaj secili nga nxënësit ka detyrë të tregojë një reklamë, të cilën e kujton. Reklama mund të jetë videoreklamë, radioreklamë, reklamë që e kanë parë në revistë, në internet, në billboard etj.

Nga diskutimi, mësimitdhënësi/mësimitdhënësja sqaron se reklamat janë bërë në mënyrë interesante, që ta tërheqin vëmendjen tonë, duke shfrytëzuar muzikën, ngjyra të dukshme, fotografi, ilustrime dhe efekte që lënë përshtypje.

Ai/ajo konkludon se reklamat mund t'i shohim në revista, në televizion, në Jutjub, t'i dëgjojmë në radio, por edhe në rrugë, në billboard, në autobusë, mund të vendosen edhe në godina dhe në objekte të tjera.

Pjesa përmbyllëse e orës mësimore

1 Aktiviteti

Çfarë reklama na pëlqejnë? (realizimi 10 minuta)

Nxënësit e shikojnë reklamën fëmijërore për lëngjet "Viva"
(<https://www.youtube.com/watch?v=WmnRxXNmLAY>).

Pastaj nxënësit duhet të përgjigjen në pyetjet vijuese të arsimtarit, përmes së cilave duhet të nxirren informata nga përmbajtja reklamuese që e kanë parë:

↳ Për çfarë flitet në reklamë?

↳ Çfarë mbajtët mend nga reklama?

↳ Çfarë reklamash janë më interesante (reklama me muzikë, me këndim, reklama qesharake, me personalitete të njohura ose me superheronj)?

Mësimitdhënësi konkludon se çdo reklamë përcjell ndonjë porosi në mënyrë interesante deri te publiku, por qëllimi kryesor më shpesh është të shitet ndonjë prodhim (ushqim, lojëra etj.)



Reflektim

↳ Çfarë mësuat në orën e sotme?

↳ Pse shërbejnë reklamat?

↳ Cilat reklama janë më interesante për ta?

Ora 4

Analizojmë filmat e animuar

Standardi i vlerësimit:

Nxënësi/nxënësja:

- parashtron pyetje lidhur me përmbajtjen mediatike (film i animuar/emision televiziv).

Burime për orët:

- fotografi nga seriale të animuara;
- projektor dhe film i animuar (sipas mundësive);
- internet.

Pjesa hyrëse e orës mësimore

1 Aktiviteti

Dua të jem si... (realizimi 10 minuta)

Nxënësit janë të ulur në rreth. Mësimdhënësi/mësimdhënësja u jep kahe nxënësve që t'ia japin topin njëri-tjetrit dhe secili prej tyre kur do ta merr topin, duhet të tregojë se cili hero/heroinë dëshiron të jetë. Mund të jetë ndonjë personazh nga filmat ose nga filmat e animuar, nga librat ose revistat me fotografi, që ua kanë lexuar ose i kanë lexuar etj.

Përderisa nxënësit i thonë emrat e heronjve, mësimdhënësi i shkruan në tabelë.

Pastaj mësimdhënësi ua shtron pyetjet vijuese nxënësve:

- Pse duam të jemi ai personazh?
- Çfarë e bën atë personazh (heroi im) të veçantë? Cilat cilësi i ka ai?
- Cilat veçori/fuqi që i ka heroi yt do të doje t'i kesh edhe ti? Pse?

Pas përgjigjeve të marra, topi jepet tek nxënësi/nxënësja tjetër dhe përsëritet procesi.

Pjesa kryesore e orës mësimore

1 Aktiviteti

Filmat e dashur vizatimorë (realizimi 20 minuta)

Mësimdhënësja/mësimdhënësja tregon disa fotografi nga serialet e animuara, që janë të popullarizuara tek fëmijët e kësaj moshe .

Pastaj nxënësit të ndarë në grupe zgjedhin njëren nga përrallat, sipas së cilave edhe grupi e fiton emrin, për shembull: Peshku Nemo. Nxënësit në çdo grup diskutojnë për përrallën mbi bazën e pyetjeve, që ua ofron mësimdhënësi:

- Pse e duan këtë tregim?
- Çfarë është më interesante në të?
- Cilin e kanë karakter të dashur? Pse?

↳ Cilin karakter e duan më shumë? Pse?

↳ Vallë ka disa disa pjesë që nuk u pëlqejnë?

Një nxënës I çdo grupi duhet të rrëfejë ndonjë episod të ndonjë seriali të dashur.

Pastaj mesimdhënësi zhvillon diskutim, me çka i nxit nxënësit të mendojnë rreth pyetjeve si vijon:

↳ Vallë atë që e kanë parë mund të ndodh në realitet ose vetëm në seriale të animuara?

↳ A ekzistojnë çështje që nuk mund të ndodhin në jetën reale? Pse?

Pastaj të gjithë së bashku tentojnë të kujtohen për çështjet që u pëlqejnë të gjithëve, për shembull se karakteri i dashur është i mirë, i ndershëm, i guximshëm...

Pjesa përmbyllëse e orës mesimore

1 Aktiviteti

Çfarë mund të mësojmë nga filmat e animuar? (realizimi 10 minuta)

Nxënësit bisedojnë për seriale të dashura dhe heronjtë e animuar dhe përgjigjen në disa pyetje vijuese:

↳ Çfarë na mësojnë heronjtë e serialeve tona të animuara?

↳ Cilat janë punët e mira, që mund t'i mësojmë nga ata?

↳ Cilat janë gjërat e këqija që i kemi parë në filmat e animuar?

↳ Cilët heronj filmikë luftojnë kundër gjërave të këqija?



Reflektim

↳ Çfarë mësuat në orën e sotme?

↳ Çfarë ju pëlqeu më së shumti nga aktivitetet në orë?

↳ Çfarë arritët të mësoni nga personazhet tuaj të dashur në filmat e animuar?

Ora 5

*Si kuptojmë
se cili ushqim
është i
shëndetshëm*

Standardi i vlerësimit:

Nxënësi/nxënësjë zhvillon vetëdije për:

- të treguar përmbajtjen e shfaqjes sipas pyetjeve të dhëna.

Burime për orët:

- tabelë e mençur/projektor LCD;
- lidhje interneti;
- pajisje për vizatim/shkrim;
- hamerë;
- pajisje për ngjyrosje.

Pjesa hyrëse e orës mësimore

1 Aktiviteti

Çfarë dua të ha, çfarë jo (realizimi 10 minuta)

Nxënësit renditen në rreth. Një nga një tregojnë se cilat i kanë ushqime të preferuara, ndërsa cilat nuk duan t'i hanë. Mësimdhënësi/mësimdhënësjë i pyet se pse pikërisht ato ushqime u pëlqejnë dhe për cilat shkaqe disa ushqime nuk i duan.

Pjesa kryesore e orës mësimore

1 Aktiviteti

Ushqimi i shëndetshëm (realizimi 20 minuta)

Nxënësit e shikojnë videon e këngës "Ushqim i shëndetshëm pa mangësi" <https://www.youtube.com/watch?v=pnFi2HOles0> nga emisioni edukues "5 plus".²

Mësimdhënësi/ mësimdhënësjë e lëshon këngën disa herë. Pastaj i ndan nxënësit në disa grupe dhe së bashku bisedojnë për atë që kanë mësuar. Duhet të mendojnë se cilat nga prodhimet në video janë vlerësuar si të shëndetshme dhe cilat jo.

E radhës, çdo grup ka për detyrë që në hamer t'i vizatojë ose ngjyroj prodhimet, që i kanë dëgjuar në këngë dhe janë vlerësuar si të mira për shëndetin. Çdo grup zgjedh prezantuesin e vet, i cili do ta prezantojë punën e tyre dhe hamerin që e kanë punuar.

Pas prezantimit të punës së përbashkët, mësimdhënësi së bashku me nxënësit diskutojnë për pyetjet vijuese:

- Cilat ushqime janë të shëndetshme?
- Pse janë të shëndetshme?
- Vallë i hamë shpesh?

² Mësimdhënësi e përkthen këngën në gjuhën në të cilën zhvillohet mësimi ose gjen këngë/tekst që ka përmbajtje të ngjashme.

- Vallë dëgjuat në këngë cilat ushqime nuk janë shumë të shëndetshme dhe nuk duhet të hahen shpesh?
- Vallë tani diçka do të ndryshojmë në të ushqyerit tonë?

Nga diskutimi, mësimitdhënësi konkludon se nga kënga që kanë dëgjuar, kanë marrë informacion për atë se cili ushqim është i shëndetshëm dhe cilin duhet ta shmangin si të dëmshëm për shëndetin. Në mënyrë të njëjtë nxënësit mund të gjejnë informacione në libra, revista, televizion etj. mbi ushqimin e shëndetshëm dhe jo të shëndetshëm.

Pjesa përmbyllëse e orës mësimore

1 Aktiviteti

Prodhimet e shëndetshme dhe të dëmshme (realizimi 10 minuta)

Në bazë të videos së shikuar, nxënësit duhet të ngjisin fotografi, që do t'i prenë nga revistat e prodhimeve të shëndetshme dhe të atyre që nuk janë të mira për shëndetin. Fotografitë duhet t'i ngjisin në Fletën e Punës 1.



- Çfarë mësuat në orën e sotme?
- Si mund ta shfrytëzojmë atë që e mësuam në jetën e përditshme?
- Çfarë ju pëlqeu më së shumti nga ora? Pse?
- Vallë diçka do të ndryshojmë në shprehjet tona pas kësaj ore?





Fletë pune – Cilat prodhime janë të shëndetshme, ndërsa cilat janë të dëmshme për shëndetin tuaj?

Prodhime të favorshme për shëndetin e fëmijëve	Prodhime të dëmshme për shëndetin e fëmijëve
√	X

√	X

√	X

NGJARJE

KULTURORE

(SHFAQJE TEATRORE

PËR FËMIJË,

SHFAQJE ME

KUKULLA

(3 orë)



Ora 2

Shfaqje për fëmijë

Kjo përmbajtje duhet të realizohet në dy orë. Në orën e parë **(Ora 1)** nxënësit shikojnë shfaqje teatrore në internet ose në teatër për fëmijë / teatër të kukullave.

Standardi i vlerësimit:

Nxënësi/nxënësja:

- ↘ e rrëfen përmbajtjen e shfaqjes pas pyetjeve të dhëna.

Burime për orët:

- ↘ kubi i përpunuar paraprakisht;
- ↘ projektor/tabelë e mençur.

Pjesa hyrëse e orës mësimore

1 Aktiviteti

Bisedë për shfaqjen teatrore (realizimi 10 minuta)

Pasi nxënësit në orën paraprake **(Ora 1)** kanë shikuar shfaqjen, të ulur në rreth bisedojnë rreth saj, duke iu përgjigjur pyetjeve të mësimdhënësit:

- ↘ Si quhej shfaqja?
- ↘ A e dini kush është autor/kush e ka shkruar tekstin?
- ↘ Çfarë ju pëlqeu në shfaqje?

Pjesa kryesore e orës mësimore

1 Aktiviteti

Punë përmes teknikës së kubit (realizimi 20 minuta)

Nxënësit qëndrojnë ulur në rreth. Para tyre është fotografia/posteri i shfaqjes së parë dhe kubi, që mësimdhënësi/mësimdhënësja e ka përgatitur para orës. Kubi në çdo nga gjashtë anët ka një pyetje. Çdo nxënës me radhë e hedh kubin dhe në varësi nga ajo se cila pyetje do t'i bie, duhet të japë përgjigje përkatëse:

- 1. Trego** për atë se çfarë ishte shfaqja – Për çfarë ishte shfaqja, çfarë mbajtët mend nga shfaqja?
- 2. Përshkruaje** skenën – Si dukej skena, çfarë objekte kishte dhe cilat ngjyra i kishin?
- 3. Përshkruaji** personazhet – Cilat ishin personazhet në shfaqje? Cilët ishin të mirë, cilët të këqinj, qesharakë.....?
- 4. Krahaso** me filmin e vizatuar – Çfarë dallon midis shfaqjes dhe filmit të animuar? Çfarë më shumë të pëlqen – shfaqja teatrore ose filmi i vizatuar?
- 5. Ndërlidh** me personazhe që i di – Vallë ndonjë personazh ju kujton ndonjë personazh tjetër nga realiteti ose filmi i vizatuar?
- 6. Zbato** – Vallë ju pëlqeu fundi i shfaqjes? Nëse jo, si do ta ndryshonit?

Pjesa përmbyllëse e orës mësimore

1 Aktiviteti

Personazhi im i shfaqjes (realizimi 10 minuta)

Çdo fëmijë duhet ta zgjedh personazhin e tij të dashur nga shfaqja, ta vizatojë dhe ta ngjyros. Pastaj në pyetjen e mësimdhënësit/mësimdhënëses duhet të sqarojë një veti, për shkakun e së cilës e ka zgjedhur pikërisht atë personazh (p.sh. i mirë, i guximshëm, qesharak, i tërbuar, i hidhëruar etj.).



Reflektim

- Çfarë mësuat në orën e sotme?
- Çfarë ju pëlqeu më së shumti nga aktivitetet në orë? Pse?
- Si duket një shfaqje teatrore dhe pse është ndryshe nga filmi?

1 Shtojcë

Personazhi i preferuar nga shfaqja, për të vizatuar dhe ngjyrosur.

Ora 3

Përgatitëni shfaqje në orë

Standardi i vlerësimit:

- ↳ tregon përmbajtjen e shfaqjes sipas pyetjeve të dhëna.

Burime për orët:

- ↳ shkopinj nga druri ose pipëz për lëng;
- ↳ pajisje për vizatim ose ngjyrosje;
- ↳ letra dhe hamer;
- ↳ ngjites.

Pjesa hyrëse e orës mësimore

1 Aktiviteti

Përgatitëni personazhe për shfaqjen (realizimi 15 minuta)

Në vazhdim të orës paraprake, nxënësit zbatojnë aktivitete lidhur me shfaqjen për fëmijë, që e kanë parë. Të ndarë në disa grupe, bashkërisht duhet t'i luajnë rolet kryesore në shfaqje. Çdo grup do të ketë detyrë të përgatitë personazhe të ndryshme, ta vizatojë në hamer, ta ngjyros dhe ta presë me gërshtë. Pastaj, me ngjites duhet ta ngjites në pipëz ose në shkop. Personazhet e punuar në këtë mënyrë, do të përdoren për aktivitetet në pjesën kryesore të orës. Nëse në shfaqje ka pasur më shumë personazhe, zgjidhen kryesorët, por duhet pasur kujdes të ketë personazhe/mashkullorë dhe femërorë.

Pjesa kryesore e orës mësimore

1 Aktiviteti

Luajtja e shfaqjes (realizimi 20 minuta)

Nga një nxënës i grupit merr pjesë në shfaqje, ndërsa njëri është rrëfyesi (narratori), përderisa nxënësit e tjerë janë publiku. Aktorët dhe narratori tentojnë të riprodhojnë shfaqjen, ashtu siç e kanë mbajtur mend.

Mësimdhënësi/mësimdhënësja i nxit nxënësit të jenë kreativë dhe të shtojnë pjesë të tyre aty ku nuk kujtohen për tregimin. Është e rëndësishme që tregimi ta merr rrjedhën e tij dhe të prezantohen komponentët më të rëndësishëm. Pastaj, nxënësit në grup i "ndryshojnë" rolet. Çdokush duhet të jetë në rolin e aktorit dhe të narratorit.

Pjesa përmbyllëse e orës mësimore

1 Aktiviteti

Bisedë për shfaqjen (realizimi 5 minuta)

Pas shfaqjes të gjithë ulen të bisedojnë për atë që e kanë parë dhe e kanë ndier.

Mësimdhënësi/mësimdhënësja e drejtojnë diskutimin përmes disa pyetjeve:

- Çfarë më së shumti ju pëlqen në shfaqje? Pse?
- Çfarë konsideroni se mungon, çfarë do të kishit përfshirë ju në shfaqje?
- Çfarë na mëson kjo shfaqje?
- Çfarë ndjenjash keni përderisa e shikoni (zemërim, lumturi...)?
- Çfarë ndjenjash kishin ata që e shfaqën (a ishin nervozë, të frikësuar, të gëzuar...)?



Reflektim

- Çfarë mësuat në orën e sotme?
- Çfarë ju pëlqeu më shumë në shfaqje? Pse?
- A është argëtuese të jepet ose të shihet shfaqja teatrore?



1 Shtojcë

Ilustrime nga shfaqjet teatrale





